# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434837**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjyqtarë, para dhe politikë - Avokati: Padia në SPAK, e rrezikshme. Gjyqësori po bëhet palë me opozitën |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/gjyqtare-para-dhe-politike-avokati-padia-ne-spak-e-rrezikshme-gjyqesori--i585163` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 11:42:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 12:35:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `493ea2fe3a423d42450fd0c1989e8fbc0d38282aa0095b8e6d3557b06e5c6b1c` |
| TEKSTI | `112786fb05f299abfd61bd02ea4d8d5635a8b8fc2eb50faf8f576d890cc4287e` |
| PAMJA | `240f53a54b365acb19d188ed4eb50abbc4e11a1f465949fa1d87deef340374af` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `aa0574899c3b41a0b34134696e4ef8c7df164b029d923c6ac689b09a56fa9471` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/aa0574899c3b41a0b34134696e4ef8c7df164b029d923c6ac689b09a56fa9471`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Gjyqtarë, para dhe politikë - Avokati: Padia në SPAK, e rrezikshme. Gjyqësori po bëhet palë me opozitën

10 Shtator 2026, 14:35Kronika TEMA

Gjyqtarë, para dhe politikë - Avokati: Padia në SPAK, e

Avokati Idajet Beqiri thotë se padia e magjistratëve për ministrin e Financave, lidhur me ngërçin për pagat e tyre, është aventureske dhe e rrezikshme.

Në një intervistë për “Tirana Live” në ABC News, Beqiri u shpreh se duhet të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe të jetë Kuvendi që do të përcaktojë pagat e gjyqtarëve.

Sipas Beqirit, kjo situatë po krijohet për destabilitet, teksa shtoi se pushteti gjyqësor po bëhet palë me opozitën.

“Është ngërç institucional, që tregon se institucionet në vend nuk funksionojnë, nuk i koordinojnë punët, nuk bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Nër astin konkret, kemi të bëjmë me indeksimin e pagave dhe prokruroëve. Derisa nuk kuptohesh me qeverinë që ka buxhetin e shtetit, dhe ju keni mospajtime, e çoni çështjen në Gjykatën e Lartë, është çështja juaj. Si zgjidhet kjo çështje? Ky vendimi i Gjykatës Kushtetuese kthehet në titull ekzekutiv, apo qeveria nuk e zbaton dot, sepse buxheti i shtetit bëhet me ligj të posaçëm. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese do shkojë në Kuvendin e Shqipërisë. Pushteti gjyqësor nuk duhet të bëjë veprime aventureske. Kjo nuk është logjikë juridike, është logjikë antishtet. Është e rrezikshme kur e bën pushteti gjyqësor. Këta, derisa doli vendimi i Gjykatës Kushtetuese, do presin ligjin, nuk do fusin njerëzit në konflikt. Kryeministri në rastin konkret, është konsultuar me juristë. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese do shkojë patjetër në parlament, parlamenti do vendosë me ligj të posaçëm.

Kjo është për të krijuar një lloj tollovie. Pushteti gjyqësor po bëhet palë me opozitën, me protestën. Kjo është e rrezikshme, antikombëtare dhe antishqiptare. Kur bëhet një padi, duhet të shkojë në gjykatë, hidhet shorti dhe e merr gjyqtari. Ne, në 17 shtator do vendoset me ligj. Pse duhet kjo padi, kur do zgjidhet çështja në 17 shtator? Vetëm për destabilitet. Ata që bënë padi, janë celula të opozitës së mbrapshtë. Janë plane që i interesojnë Greqisë dhe Serbisë. Zgjidhja e vetme është ligji që do nxjerrë parlamenti. Kjo që po bëhet është kundër interesave të Shqipërisë, theksoi ai./**abcnews.al**

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN


“Helsinki” letër Burgut 313: Jepini fund shkeljes së të drejtave të ish-presidentit Meta

13:35 Kronika

[Bllokuan rrugët dhe u përplasën me policinë, 1 i arrestuar dhe 15 nën procedim pas protestës]

12:43 Kronika / 1 koment

[Projektligji i ri në Kuvend - Subjektet me ndërtime pa leje 6 muaj kohë për vetëdeklarim. Shteti merr përsipër pallatet e lëna përgjysmë]

12:05 Kronika

[Pagat e magjistratëve, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kallëzojnë Ministrinë e Financave në SPAK]

11:48 Kronika / 10 komente

[Sokol Sadushi: Bllokimi i pagave, jo më çështje financiare, por çështje kushtetuese]

11:45 Kronika / 5 komente

[Projektligji për pagat e gjyqtarëve - Ministri i Drejtësisë: Kuvendi do ta shqyrtojë në 17 shtator]

11:35 Kronika

[Ngërçi për pagat përfshin edhe Beratin, Gjykata në bojkot: Trajtohen vetëm masat e sigurisë dhe urdhrat e mbrojtjes]

11:25 Kronika / 2 komente

[Shpërthimi te karburanti në "Brryl", dy pistat e hetimit! Zbardhen dëshmitë e punonjësve, nga pompa me defekt, te rrjedhja e gazit]

10:45 Kronika / 6 komente

[Ngërçi me pagat në drejtësi, sot mblidhen gjyqtarët! Administrata e gjykatave të Tiranës, Vlorës, Fierit dhe Lushnjës në bojkot]

08:35 Kronika / 7 komente

[Dhunohet drejtori i Ujësjellësit në Elbasan/ Luan Tabaku u godit me sende të forta nga dy persona]

07:34 Kronika / 2 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**[Republika popullore e protestës]**

15:20 Editorial / 113 komente

**["A nuk ju vjen turp?" - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...]**

11:53 Politika / 101 komente

**Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...**

14:50 Kronika / 19 komente

**U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...**

15:13 Politika / 73 komente

**Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...**

13:40 Bota / 40 komente

## Blog Tema

**Përse do të jetë "fair" që Erion Veliaj të lirohet**

12:38 Blog / 5 komente

**Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?**

10:25 Blog / 19 komente

**Dinjitet nuk ka vetëm deputeti…**

09:42 Blog / 21 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.